



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 100

Tiranë – E martë, 9 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 360, datë 26.4.2017	Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave” 5561
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 361, datë 26.4.2017	Për dhënien në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Kulturës, për Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 4 930 m ² , brenda territorit të pronës nr.108, me emërtim “Batalioni i mbështetjes, (Ish-reparti ushtarak nr.1070)”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë..... 5566
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 362, datë 26.4.2017	Për miratimin e kontratës nr. 5758 prot., datë 25.4.2017, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Bashkimit të Shoqërive “Admiral Sportwetten”, GMBH, “Atsi”, Spolka Akcyjna, “Mc Networking”, sh.p.k., “Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit qendror të monitorimit <i>on-line</i> (SQMO) për industrinë e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë” 5574
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 364, datë 26.4.2017	Për transferimin e pronësisë së 30 për qind të kuotave të shoqërisë “Superbeton”, sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Bashkisë Tiranë..... 5574
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 26.4.2017	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Arkivi digjital i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit” 5574
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 366, datë 26.4.2017	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Entin Kombëtar të Banesave, të zyrave në katin e pestë të godinës së Ish-Shtëpisë Botuese “Naim Frashëri”, Tiranë..... 5575
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 367, datë 26.4.2017	Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet informale..... 5576

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 368, datë 26.4.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.488, datë 22.7.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e çmimit favorizues të shitjes së parcelës ndërtimore për ndërtimet pa leje, me funksion banimi dhe të përzier, të subjekteve që përfitojnë falje të pagesës, si dhe të mënyrës e afateve të pagesës”, të ndryshuar.....	5588
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 369, datë 26.4.2017	Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era.....	5588
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 370, datë 26.4.2017	Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë.....	5596
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 371, datë 26.4.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr.1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve”	5597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 26.4.2017	Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2017-2020.....	5598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 373, datë 26.4.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në shërbimin spitalor”	5598
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 374, datë 26.4.2017	Për mbulimin e plotë të shpenzimeve të mjekimit të z. Arben Hysko.....	5600
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.375, datë 26.4.2017	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Enkelejda Mamaj (Baba)	5601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 376, datë 26.4.2017	Për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Anxhela Noçka.....	5601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 377, datë 26.4.2017	Për dhënie pensioni të posaçëm familjarëve në ngarkim të të ndjerit Andrea Stefani.....	5601
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 378, datë 26.4.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i bllokut të kufizuar nga rrugët “Sulejman Delvina”, ‘Medar Shtylla’, ‘Skënder Luarasi’, ‘Grigor Heba’ dhe ‘Gjik Kuqali’, Tiranë”	5602
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.379, datë 26.4.2017	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në zonën turistike Gjiri i Lalëzit, Durrës”	5606
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 380, datë 26.4.2017	Për disa ndryshime në vendimin nr.274, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës që lidh ndërtesën e re të qendrës dispeçer dhe Zyrat e “OST”, sh.a.-së, me nënstacionin 400 kv Kashar”	5607

**VENDIM****Nr. 360, datë 26.4.2017****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15, pika 2, e 94, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimet nr. 123, datë 4.3.2004, nr. 157, datë 25.3.2005, nr. 158, datë 25.3.2005, nr. 159, datë 25.3.2005, dhe nr. 160, datë 25.3.2005, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****RREGULLORE****“PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE”****KREU I****DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
ARKIVAVE****Neni 1****Misioni i Drejtorisë së Përgjithshme të
Arkivave**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave është institucion qendror, në varësi të Kryeministrit. Ajo është autoriteti më i lartë metodiko-profesional i rrjetit arkivor kombëtar.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave u propozon për miratim organeve të parashikuara me ligj standarde ligjore, nënligjore e profesionale të detyrueshme për zbatim në të gjithë rrjetin arkivor të vendit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave raporton me shkrim për veprimtarinë e saj, jo më pak se dy herë në vit, para Këshillit të Lartë të Arkivave.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka për detyrë të bëjë të njohur, në shkallë vendi, ligje, vendime, udhëzime si dhe vendimet këshillimore (rekomandimet) të organizmave ndërkombëtare, ku arkivat shtetërore të vendit janë anëtare, që kanë të bëjnë me administrimin e dokumentit, përgjatë gjithë ciklit të jetës së tij.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka për detyrë të bashkëpunojë me institucionet e qeverisjes dhe të administratës shtetërore, qendrore e vendore, si dhe me organet joshtetërore, për administrimin ligjor të pasurisë arkivore, kudo që ajo ekziston ose krijohet.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përgjigjet për plotësimin e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve dhe të subjekteve shtetërore e joshtetërore për shërbimin që ofrohet nga Arkivi Qendror Shtetëror dhe Arkivat Shtetërore Vendore.

Neni 2**Struktura e Drejtorisë së Përgjithshme të
Arkivave**

Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave miratohen nga Kryeministri.

Neni 3**Drejtori i Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave është titullari i institucionit. Drejtori i Përgjithshëm i Arkivave ka këto detyra:

a) Është kryesuesi i rrjetit arkivor kombëtar dhe ushtron drejtimin metodiko-profesional të punës në arkivat shtetërore të sistemit, arkivat e institucioneve të administratës shtetërore në veprim dhe në arkivat e tjera, të parapara në ligjin “Për arkivat”;

b) Nënshkruan marrëveshjet e bashkëpunimit ndërinstitucional;

c) Përfaqëson arkivat shtetërore të vendit në organizmat dhe institucionet ndërkombëtare, ku ato janë anëtarësuar, dhe ushtron të drejtën e votës në emër të tyre;

ç) Nënshkruan, në emër të institucionit që drejton, marrëveshje dy ose më shumë palëshe për bashkëpunim ndërarkivistik me partnerë të huaj;



d) Përgjigjet për veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;

dh) U rekomandon organeve përgjegjëse, institucioneve të pushtetit e të administratës qendrore e vendore dhe subjekteve joshtetërore shfuqizimin e akteve administrative joligjore për punën me dokumente, të miratuara prej tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

e) Bashkërendon punën e strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, i ndihmon ato për funksionimin normal dhe zgjidh çështjet që tejkalojnë përgjegjësitë e tyre si dhe miraton rregullore, urdhra e udhëzime për funksionimin e brendshëm të strukturave;

ë) Miraton planet vjetore të drejtorive që funksionojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme;

f) U delegon autoritet përfaqësimi drejtorëve të drejtorive për probleme të ndryshme të punës, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

g) Lëshon autorizimin e inspektimit, në përputhje dhe në bazë të programit të miratuar të inspektimit;

gj) Vendos për shtyrjen e kohëzgjatjes së autorizimit, zëvendësimin e inspektorëve, gjatë inspektimit, shqyrton ankimin e veçantë ndaj vendimeve për masat urgjente të marra nga inspektorët, sipas ligjit.

Neni 4

Funksionet e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ka këto funksione:

a) Kryen përpunimin tekniko - shkencor të dokumenteve të depozituara në Arkivin Qendror Shtetëror, kur ato janë pranuar sipas ligjit “Për arkivat”;

b) Kryen evidencimin korrekt të fondeve;

c) Ndjek, zbaton dhe kontrollon kërkesat teknologjike të ruajtjes fizike të dokumentave të fondeve që ruhen në AQSH dhe bën shërbimet e nevojshme për mirëmbajtjen e dokumenteve e mikrofilmave që janë në ruajtje dhe administrim të përhershëm ose të përkohshëm në DPA; siguron ruajtjen fizike të dokumenteve e mikrofilmave, duke zbatuar rregullat për mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e tyre;

ç) Kryen veprimet e pranimit të dokumenteve që kalojnë për ruajtje të përhershme nga ministritë dhe institucionet qendrore në AQSH, sipas

përparësisë dhe kryen veprimet për marrjen në dorëzim të dokumenteve të dhuruara e të blera;

d) Bën restaurimin, trajtimin kimik dhe dezinfektimin e dokumenteve;

dh) Organizon dhe ndjek zbatueshmërinë metodologjike-profesionale të veprimtarisë arkivore në të gjithë vendin, në arkivat shtetërore e ato joshtetërore, në sekretari-arkivat e institucioneve qendrore e vendore në veprim, dhe propozon përsosjen e shërbimit për njësi të veçanta apo për gjithë rrjetin arkivor kombëtar;

e) Kontrollon zbatimin e ligjit për arkivat si dhe të akteve nënligjore për punën me dokumentet në gjithë rrjetin arkivor të vendit, pavarësisht nga vartësia e tyre administrative. Ajo e ushtron këtë përgjegjësi edhe në arkivat e personave juridikë e fizikë privatë, që administrojnë dokumente me rëndësi historike kombëtare; Vendos sanksione ligjore, bazuar në legjislacionin në fuqi;

ë) Organizon punën për hartimin e projekteve dhe paraqet për miratim standarde të reja ligjore e nënligjore, studime, literaturë teorike e mjete metodike për punën me dokumentet dhe arkivat;

f) Organizon dhe drejton përgatitjen profesionale e bashkëpunimin e arkivistëve të të gjitha niveleve në shkallë kombëtare, nëpërmjet kurseve afatshkurtra dhe afatmesme për kualifikimin e arkivistëve e të punonjësve të sekretari-arkivave; bën seminare tematike për probleme të punës arkivore në shkallë kombëtare si dhe drejtimin e konferencave ndërkombëtare, që ndërmerren si iniciativa prej Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe partnerëve të saj;

g) Ndjek, zbaton dhe kontrollon procedurat e krijimit, të ruajtjes dhe të aksesit të dokumenteve të digjitalizuara dhe të mikrofilmuara të fondeve që ruhen në AQSH, sipas normave tekniko-shkencore të hartuara për këtë qëllim dhe rregullores së brendshme të digjitalizimit;

gj) Siguron shërbim për punonjësit e autorizuar nga ministritë dhe institucionet e tjera fondkrijuese, si dhe për personat juridikë e privatë, duke vënë në dispozicion të tyre mjetet e kërkimit e të informimit arkivor, dokumentet, sipas kërkesës së porositesit dhe rregullores së brendshme për shërbimin me dokumentet, si dhe ndjek shfrytëzimin e përdorimin e tyre;

h) Bën modernizimin e vijueshëm të mjeteve të kërkimit arkivor, harton, aparate informative shkencore të llojeve të ndryshme, në përputhje me



skemën e klasifikimit të dokumenteve, si katalogë, udhërrëfyes, historikë fondesh, regjistra dhe botime të tjera me karakter njohës-informues;

i) Përgatit dhe organizon evente të ndryshme me karakter promovues e shkencor; mirëmban muzeun, fonotekën dhe fototekën;

j) Menaxhon burimet njerëzore, çështjet ligjore, teknologjinë e informacionit, mirëmbajtjen dhe shërbimet e tjera mbështetëse;

k) Përgatit dhe zbaton buxhetin, mbajtjen e kontabilitetit dhe kryerjen e auditimit të brendshëm të institucionit.

Neni 5

Inspektimi

1. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave funksionon një strukturë përgjegjëse për inspektimin, bazuar në legjislacionin në fuqi për inspektimet.

2. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionon “Komisioni i Ankimimit”, që shërben për shqyrtimin e ankimimeve administrative kundër vendimeve përfundimtare të inspektimit, sipas procedurave të Kodit të Procedurave Administrative. Komisioni miratohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm.

3. Titullarët e arkivave shtetërore vendorë kryejnë funksionet inspektuese për subjektet nën juridiksionin e tyre, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimet.

Neni 6

Arkivat shtetërore vendorë (ASHV)

1. Arkivat shtetërore vendorë kanë varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe kanë të njëjtin objekt pune me Arkivin Qendror Shtetëror, si dhe detyra e përgjegjësi të tjera, të përcaktuara në rregulloren e brendshme të funksionimit të tyre, brenda juridiksionit të përcaktuar në ligjin “Për arkivat”.

2. Mënyra dhe organizimi i arkivave shtetërore vendorë bazohet në strukturën e miratuar sipas nenit 2, të kësaj rregulloreje, dhe rregullores së brendshme.

KREU II

ORGANET QË FUNKSIONOJNË PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE

Neni 7

Organet që funksionojnë pranë DPA-së

1. Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave funksionojnë:

a) Këshilli i Lartë i Arkivave (KLA);

b) Komisioni Qendror i Ekspertizës (KQE);

c) Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH)

ç) Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve (KPE).

2. Përbërja, detyrat dhe veprimtaria e tyre zhvillohen në përputhje me këtë rregullore dhe me rregulloret e tyre të brendshme.

3. Mandati i anëtarëve të këtyre organeve është tre vjet dhe ndërpritet kur anëtari:

a) mungon tri herë radhazi pa arsye;

b) jep dorëheqjen;

c) nuk punon më në institucionin që e ka caktuar.

4. Përbërja e tyre përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave, pas zgjedhjes së anëtarëve të brendshëm dhe caktimit të anëtarëve të jashtëm. Mbledhja e parë bëhet jo më vonë se një muaj nga data e njoftimit të përbërjes nominale. Në mbledhjen e parë bëhet zgjedhja e sekretarit.

5. Mbledhja e këtyre organeve thirret nga kryetari ose nga një e treta e anëtarëve të saj. Ajo mbahet kur është e pranishme shumica e anëtarëve dhe jo më pak se një herë në vit. Rendi i ditës dhe aktet për diskutim vihen në dispozicion të anëtarëve jo më vonë se një javë para datës së mbledhjes. Çdo anëtar ka të drejtë të bëjë propozime për ndryshime e shtesa në rendin e ditës. Propozimet miratohen ose kundërshtohen me votimin e shumicës së thjeshtë të pjesëmarrësve në mbledhje. Votimi kundër i anëtarit duhet të shoqërohet me shpjegim me shkrim. Në rastet kur votimi del i barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 8

Këshilli i Lartë i Arkivave (KLA)

1. KLA-ja është organ ndërinstitucional vendimmarrës, para të cilit Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave raporton për veprimtarinë



e saj, jo më pak se dy herë në vit. Detyra kryesore e KLA-së është të miratojë strategjitë afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra të zhvillimit të shërbimit arkivor, që kanë të bëjnë me politikën arkivore të shtetit.

2. KLA-ja përbëhet nga 17 anëtarë, 8 të brendshëm dhe 9 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë përfaqësuesit e zgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm, nga radhët e drejtuesve të njësive organizative të DPA-së. Anëtarët e jashtëm të KLA-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si më poshtë vijon:

- a) Tre përfaqësues të Akademisë së Shkencave;
- b) Dy përfaqësues të ministrisë që mbulon çështjet e trashëgimisë kulturore;
- c) Dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës;
- ç) Dy përfaqësues të arkivave të sistemit. Këta të fundit zgjidhen me votim të fshehtë, nga mbledhja e drejtorëve të tyre.

3. Kryetar i KLA-së është drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës të mbledhjes së KLA-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e marra.

4. Sekretari i KLA-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtari i KLA-së që ka specializim në fushën e arkivave. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KLA-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

5. KLA-ja miraton, paraprakisht:

- a) të gjitha aktet që kanë të bëjnë me strategjinë afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimit të shërbimit arkivor kombëtar;
- b) projektaktet ligjore e nënligjore që DPA-ja rekomandon, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit arkivor kombëtar;
- c) “Listën tip” të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, të njësuar në shkallë vendi;
- ç) rregullat tekniko-profesionale dhe metodologjike të punës me dokumentet (administrative, tekniko-shkencore, në figurë, zë, lëvizje, në formë të numerizuar);
- d) rregullore me natyrë unifikuese për punën me dokumentet;
- dh) raportin e analizës vjetore të DPA-së.

Neni 9

Komisioni Qendror i Ekspertizës (KQE)

1. Detyra kryesore e KQE-së është të hartojë dhe përmirësojë, në vazhdimësi, “Listat tip” për Faqe/ 5564

dokumentet me vlerë ruajtjeje të përhershme dhe për dokumentet me vlerë ruajtjeje të përkohshme, unike, në shkallë vendi, si dhe të miratojë listat e veçimit të dokumenteve që e kanë kaluar afatin normativ të ruajtjes.

2. KQE-ja përbëhet nga 15 anëtarë, 7 të brendshëm dhe 8 të jashtëm. Anëtarë të brendshëm janë përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të zgjedhur nga drejtori i Përgjithshëm, nga radhët e nëpunësve me, së paku, 10 vjet përvojë në shërbimin arkivor. Anëtarët e jashtëm të KQE-së caktohen nga titullarët e institucioneve që përfaqësojnë, si më poshtë vijon:

- a) Një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;
- b) Një përfaqësues i Institutit të Statistikës;
- c) Një përfaqësues i Arkivit Qendror Teknik;
- ç) Një përfaqësues i Arkivit Qendror të Filmit;
- d) Dy përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për financat;

dh) Dy përfaqësues të arkivave të sistemit, të cilët zgjidhen nga mbledhja e drejtorëve të tyre, me votim të fshehtë.

3. Kryetar i KQE-së është drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e ditës të mbledhjes së KQE-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e saj.

4. Sekretari i KQE-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtari i KQE-së që ka specializim në fushën e arkivave. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KQE-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

5. KQE-ja kryen këto detyra:

- a) Përgatit “Listën tip” të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare (më tej RHK);
- b) Miraton listat e dosjeve të veçuara për asgjësim, sipas vendimeve të institucioneve të përcaktuara në ligj, për dokumentet që kanë humbur vlerën e ruajtjes së mëtejshme;
- c) Miraton listat e dokumenteve të veçuara për asgjësim nga Arkivi Qendror Shtetëror, në rast të risistemimit të fondeve. Në këtë rast, vendimi merret nga Komisioni i Ekspertizës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, pas relacionit të drejtorisë përgjegjëse për përpunimin në AQSH;
- ç) Vendimet e KQE-së u dërgohen institucioneve përkatëse dhe zbatimi i tyre ndiqet nga DPA-ja.



Neni 10

Komisioni i Përhershëm i Ekspertëve (KPE)

1. KPE-ja bën vlerësimin e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare, që janë në shitje prej subjekteve private, dhe miraton pranimin e dokumenteve nga qytetarët.

2. KPE-ja përbëhet nga specialistë të vlerësimit të trashëgimisë arkivistike kombëtare. KPE-ja përbëhet nga:

a) drejtori i Përgjithshëm i Arkivave dhe dy anëtarë të brendshëm, të emëruar prej tij;

b) dy përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore;

c) dy përfaqësues të Akademisë së Shkencave;

ç) dy përfaqësues të Universitetit të Tiranës.

3. Kryetar i KPE-së është një përfaqësues i Akademisë së Shkencave, me titull “Akademik”.

4. Sekretari i KPE-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtari i KPE-së që ka specializim në fushën e arkivave. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KPE-së në mungesë dhe me urdhër të tij.

5. KPE-ja miraton, paraprakisht,:

a) “Listën tip”, me afatet e ruajtjes së dokumenteve administrative RHK, që i paraqitet nga Komisioni Qendror i Ekspertizës;

b) shpërndarjen në vendruajtje të fondeve të dokumenteve që administrohen nga DPA-ja;

c) matricën e njësuar të përshkrimit të dokumentit RHK, që subjekti joshtetëror privat nxjerr në shitje;

ç) pranimin e dokumenteve të dhuruara;

d) vlerësimin e kushteve të parablerjes së këtyre dokumenteve. KPE-ja jep mendimin përkatës për dhënien ose jo të lejes së tregimit të lirë të dokumenteve RHK, që subjektet joshtetërore private duan të shesin. Mendimi i përcillet DPA-së, për të ushtruar të drejtën e vendimmarrjes;

dh) dërgimin dhe/ose moslejimin e nxjerrjes jashtë vendit të dokumenteve RHK në pronësi të shtetit dhe/ose të subjekteve joshtetërore private, në rast se këto dokumente përbëjnë vlera unike, në kuadër të trashëgimisë arkivore të vendit, të cilat ia përcjell drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave për hartimin e propozimit drejtuar Kryeministrit, për miratim përfundimtar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimit të nenit 83, të ligjit nr.9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”;

e) kushtet e tregimit të dokumenteve RHK, në rast të ndryshimit të pronarit privat. Këto kushte KPE-ja ia propozon DPA-së, për ushtrimin e së drejtës së vendimmarrjes. Kjo e fundit mund të kufizojë shitjen e këtyre dokumenteve deri në 30 ditë, nga data e marrjes së njoftimit prej pronarit. Kur KPE-ja nuk arrin të marrë vendim, duke u mbështetur vetëm në përshkrimet arkivistike, për të propozuar ndalimin dhe/ose të kushtëzujë shitjen e lirë të dokumenteve RHK në pronësi të subjekteve joshtetërore private, ajo ka të drejtë të njihet me vetë dokumentin, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj. Pronari joshtetëror privat i dokumenteve RHK ka të drejtën e ankimit në gjykatë kundër vendimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, sipas Kodit të Procedurave Administrative;

ë) rregullat për paraqitjen e dokumenteve arkivore në mjediset ndërkombëtare;

f) listën e pronarëve të arkivave private, të cilët u dhurojnë arkivave shtetërore dokumente të shpallura RHK.

Neni 11

Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH)

1. KDZH-ja është organizëm vendimmarrës pranë DPA-së për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar që gjendet në fondin arkivor të AQSH-së dhe ASHV-ve.

2. KDZH-ja përbëhet nga pesë anëtarë, 3 të brendshëm dhe 2 të jashtëm. Anëtarët e brendshëm emërohen nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, nga radhët e nëpunësve të certifikuar. Një anëtar i jashtëm caktohet nga DSIK-ja. Anëtari tjetër i jashtëm caktohet, për çdo vendimmarrje, nga fondkrijuesi i dokumentacionit që është në shqyrtim. Në rastet kur fondkrijuesi nuk ekziston më dhe/ose e ka pushuar veprimtarinë, mbledhja kryhet me katër anëtarët e tjerë.

3. Kryetar i KDZH-së është drejtori i Përgjithshëm i Arkivave. Kryetari miraton rendin e dës të mbledhjes së KDZH-së, drejton mbledhjen dhe nënshkruan vendimet e saj.

4. Sekretari i KDZH-së zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Sekretar mund të zgjidhet anëtari i KDZH-së që mbulon sektorë të përmbajtjes, që kanë informacion të klasifikuar. Ai ushtron përgjegjësinë e kryetarit për drejtimin e mbledhjes së KDZH-së



në mungesë dhe me urdhër të tij. Sekretari i KDZH-së kryen këto detyra:

a) Kërkon nga drejtuesit e Arkivave Shtetërore Vendore, në varësi të DPA-së, të dërgojnë listat e dokumenteve të klasifikuara “sekret shtetëror”, që kanë hyrë dhe ruhen në këto arkiva;

b) I dërgon DSIK-së bibliografinë e plotë të informacionit të deklasifikuar dhe vendimin përkatës. Një kopje e kësaj bibliografie i jepet sektorit të komunikimit në DPA. Bibliografia e informacionit të deklasifikuar disponohet lirisht nga kërkuesit;

c) Bën vlerësimin e drejtpërdrejtë të dokumentit, objekt deklasifikimi, në rastet kur nuk është e mundur të merret vendim, duke u mbështetur vetëm në të dhënat përshkrimore të dokumenteve (inventarë, skedarë). Vlerësimi i tij i paraqitet KDZH-së në mbledhjen më të afërt.

ç) Përgjigjet për kalimin në ambientet e sigurisë së lartë të informacionit të klasifikuar, që KDZH-ja vendos të mos e deklasifikojë. Vendosja e dokumenteve që mbeten të klasifikuara në mjedisin e sigurisë së lartë bëhet brenda 24 orëve, nga marrja e vendimit;

d) Vendos shenjën e deklasifikimit, në formë të pandryshueshme e të dukshme, mbi dokumentin që nuk mbart më shkallë klasifikimi, në përputhje me vendimin. Ai bën ndryshimet përkatëse në mjetet e informacionit dhe të kërkimit arkivor;

dh) Mund të propozojë deklasifikimin e dokumenteve, objekt kërkimi të studiuesve, jashtë radhës kronologjike.

e) Jep sqarimet ligjore për kërkuesin, të cilit i refuzohet shërbimi, për rastet kur dokumentet ende nuk janë deklasifikuar. Ai mbron vendimin e KDZH-së, në rastin e ankimit të tij në gjykatë, prej personave të interesuar.

KREU III DISPOZITA KALIMTARE

Neni 12 Ndryshimi i rregullores

1. Nisma për ndryshimin e kësaj rregulloreje ndërmerret nga drejtori i Përgjithshëm i Arkivave ose me propozimin e një të tretës së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Arkivave.

2. Pas nismës për ndryshim, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave ngre një grup pune, të përbërë nga drejtorët e DPA-së dhe nga një anëtar i

jashtëm i organizmave që funksionojnë pranë DPA-së. Grupi i punës drejtohet nga anëtar i jashtëm, përfaqësues i KLA-së.

3. Projektregullorja e përgatitur nga grupi i punës i paraqitet Këshillit të Lartë të Arkivave për miratim paraprak, sipas përcaktimeve të nenit 12, të kësaj rregulloreje.

Neni 13

Institucionet zbatuese

Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për zbatimin e kësaj rregulloreje.

VENDIM Nr. 361, datë 26.4.2017

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË
PËRKOHSHËM, NGA MINISTRIA E
MBROJTJES MINISTRISË SË KULTURËS,
PËR BIBLIOTEKËN KOMBËTARE TË
SHQIPËRISË, TË DISA OBJEKTEVE DHE
TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI
FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË
PËRGJITHSHME 4 930 M², BREND
TERRITORIT TË PRONËS NR. 108, ME
EMËRTIM “BATALIONI I
MBËSHTETJES, (ISH-REPARTI
USHTARAK NR. 1070)”, ME
VENDNDODHJE TE RRAPI I TRESHIT,
TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 12, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 901 e vijues, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim të përkohshëm, nga Ministria e Mbrojtjes Ministrisë së Kulturës, për Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, për një periudhë 30-vjeçare, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4 930 (katër mijë e nëntëqind e tridhjetë) m², brenda territorit të pronës nr. 108, me emërtim “Batalioni i Mbështetjes (Ish-reparti ushtarak nr. 1070)”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, sipas planvendosjes dhe



planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, për t'i përdorur për depozitimin e titujve dhe kolanave të librave të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë.

2. Ministrisë së Kulturës dhe Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e objekteve dhe të truallit funksional, pjesë të pronës nr. 108, me emërtim “Batalioni i Mbështetjes (Ish-reparti ushtarak nr. 1070)”, me vendndodhje te Rrapi i Treshit, Tiranë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t'i tjetërsojnë ato ose t'ua japin në përdorim të tretëve.


3. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, nëpërmjet Batalionit të Mbështetjes të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, dhe Ministria e Kulturës, nëpërmjet Bibliotekës

Kombëtare të Shqipërisë, të lidhin marrëveshje të përbashkët për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Kulturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe drejtori i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi





PRONA nr.108
 PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.16
 KATI I NËNDHE
 SIPËRFAQIA = 473.2 m²
 SHKALLA 1:100




Mirëditje!
 Kancelaria e Rep. H. Nr. 6630
 Kolonel Petrit DALLANI

REP. SHQIPERISE MIN. MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/kol. Ark. Ferdi HYRAJ	
Prona nr.108 Tiranë	VIZATOI	Top. Nikoll TUSHI	
Data: 30.03.2017	Përpiluar sipas originalit të marrë në Arkivin e IGJIU		



PRONA nr.108
PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.16
KATI I PËRDHE
SIPËRFAQJA = 1416.8 m²
SHKALLA 1:300




Miratolet
Komandanti i Pop. Ush. Nr. 6630
Kolonel Petrit DALLANI

REF.SHOIPËRISË MIN. MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/kol.Ark. Ferdi HYRAJ	
Prona nr.108 Tiranë	VIZATOI	Top. Nikoll TUSHI	
Data: 30.03.2017	PËRPILUAR	Sipas origjinalit të marrë në Arkivin e IGJIU	



PRONA nr.108
PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.16
KATI I PARË
SIPËRFAQJA = 1377.0 m²
SHKALLA 1:300




Mirrored
Komandant Rep. H. Nr. 6630
Kolonel Petrit DASHANI

REP. SHQIPËRISE MIN. MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/kol. Ark. Ferdi HYRAJ
Prona nr.108 Tiranë	VIZATOI	Top. Nikoll TUSHI
Data: 30.03.2017	PËRPILUAR	Sipas originalit të marrë në Arkivin e IGJIU




PRONA nr.108
 PLANIMETRIA E OBJEKTIT TUNEL nr.1
 SIPËRFAQJA = 605,5 m²
 SHKALLA 1:500



Miratolet
 Komandanti i Rep. Udh. Nr. 6630
 Kolonel Petrit DASILANI

REP.SHQIPËRISE MIN. MBROJTJES IGJIU	DREJTORI	N/kol.Ark. Ferdi HYRAJ	
Prona nr.108 Tiranë	VIZATOI	Top. Edison MEMELLI	
Data: 30.03.2017	KONTROLLOI	Top. Ramiz HAXHIU	



Mirza Ali
Kamounoudin Rep. Udd. Nr. 6630
Colonel Petat DAXANI

REP.SHQIPËRISE MIN. MBROJTJES IGJHU	DREJTORI	N/kol.Ark. Ferdi HYRJA	
Prona nr.108 Tiranë	VIZATOI	Top. Edison MEMELLI	
Data: 30.03.2017	KONTROLLOI	Top. Ramiz HAXHIU	

**VENDIM**

Nr. 362, datë 26.4.2017

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS NR. 5758 PROT., DATË 25.4.2017, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ADMIRAL SPORTWETTEN”, GMBH, “ATSI”, SPOLKA AKCYJNA, “MC NETWORKING”, SH.P.K., “PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT QENDROR TË MONITORIMIT *ON-LINE* (SQMO) PËR INDUSTRIJË E LOJËRAVE TË FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 12, të nenit 70, të ligjit nr. 155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 647, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të kriterëve të përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës nr. 5758 prot., datë 25.4.2017, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe bashkimit të shoqërive “Admiral Sportwetten”, GmbH, “ATSI”, Spolka Akcyjna, “MC Networking”, sh.p.k., “Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) për industrinë e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 364, datë 26.4.2017

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 30 PËR QIND TË KUOTAVE TË SHOQËRISË “SUPERBETON”, SH.P.K., TIRANË, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES BASHKISË TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, neneve 3 e 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 30 për qind të kuotave të shoqërisë “Superbeton”, sh.p.k., Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes Bashkisë Tiranë.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 365, datë 26.4.2017

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE “ARKIVI DIGJITAL I ARKIVIT QENDROR TEKNIK TË NDËRTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit (AQTN), “Arkivi Digjital i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit” (ADAQTN).

2. Sistemi i ADAQTN-së përmban të dhëna për:

- hartat plansheta;
- projekte ndërtimore dhe plane rregulluese;
- dosje pronësie (para viteve 1964);
- dokumentacione teknike (grafike) dhe shkresore (preventiva, recensa, detyra projektimi, korrespondenca, dorëshkrime, parashkresa teknike, vendime të këshillit teknik, vendime të këshillit të institucionit, procesverbale dhe llogaritje statike).

3. Institucioni administrues i bazës së të dhënave ADAQTN është Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit, nëpërmjet strukturës përkatëse, që mbulon çështjet e AQTN-së.

4. Të dhënat parësore dhe dytësore të ADAQTN-së janë, si më poshtë vijon:

4.1 Të dhëna parësore:

- Hartat plansheta;
- Projekte ndërtimore dhe plane rregulluese;
- Dosje pronësie (para viteve 1964);
- Dokumentacion teknike (grafike) dhe shkresor (preventiv, recensë, detyrë projektimi, korrespondencë, dorëshkrime, parashkresë teknike, vendime të këshillit teknik, vendime të këshillit të institucionit, procesverbale dhe llogaritje statike).

4.2 Të dhëna dytësore:

- Të dhënat që merren nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (NID, emri, mbiemri, atësia, rruga, gjinia, vendlindja, datëlindja, mëmësia, kodZGJC, gjendja civile, emriNJQV, lidhja me kryefamiljarin, rrethi, qarku), sipas akteve ligjore në fuqi;

- Të dhënat që merren nga Regjistri Tregtar (NUIS, emri i subjektit, aktiviteti, data e regjistrimit, statusi i subjektit, adresa e subjektit).

5. Dhënësit e informacionit, sa i përket ADAQTN-së, janë:

- Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit;
- institucionet shtetërore;
- njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë).

6. Baza e të dhënave e ADAQTN-së ndërvepron me bazën e të dhënave shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile) dhe me bazën e të dhënave shtetërore të Qendrës

Kombëtare të Biznesit (Regjistri tregtar), sipas ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

7. Baza e të dhënave të ADAQTN-së ka 3 nivele përdoruesish (*user's levels*):

- Administrator;
- Përdorues;
- Sportelist.

Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës dhe të përcaktuara në procedurat e punës, të miratuara nga drejtori i AQTN-së për secilin nga punonjësit e tij.

8. Subjekte të interesuara për ADAQTN-në janë:

- qytetarët;
- bizneset;
- institucionet publike;
- AQTN-ja.

9. Subjektet e interesuara kanë nivel aksesit si lexues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion nëpërmjet portalit *e-albania*.

10. Ngarkohet Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 366, datë 26.4.2017

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA KOMISIONERI
PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE, MINISTRISËSË
ZHVILLIMIT URBAN, PËR ENTIN
KOMBËTAR TË BANESAVE, TË ZYRAVE
NË KATIN E PESTË TË GODINËS SË
ISH-SHTËPISË BOTUESE “NAIM
FRASHËRI”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministrisë së Zhvillimit Urban, për Entin Kombëtar të Banesave, të zyrave në katin e pestë të godinës së ish-shtëpisë botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, për t’u përdorur si mjedise pune nga ky institucion.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban, Entit Kombëtar të Banesave u ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ministria e Zhvillimit Urban, Enti Kombëtar i Banesave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 367, datë 26.4.2017

**PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË
PRONARËVE TË PASURIVETË
PALUAJTSHME QË PREKEN NGA
NDËRTIMET INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 10, të ligjit nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese, të zëna nga ndërtimet informale

në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Tiranë shtetas, Vlorë, Elbasan dhe Durrës.

2. Masa e kompensimit është 20 872,79 (njëzet mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy presje shtatëdhjetë e nëntë) m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 417 065 686,31 (katërqind e shtatëmbëdhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë presje tridhjetë e një) lekë, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet pa leje, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Për numrat rendorë të pronave, (kolona 13) të shtojcës 1: 9, 20, 21, 22, 24, 40, 48, sipas seksionit të veçantë (kolona 18) të shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, pas miratimit nga kreditori, sipas pikës 12, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe rregullave për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objekteve informale”.

b) Për numrat rendorë të pronave, (kolona 13) të shtojcës 1: 12 e 47, sipas seksionit të veçantë (kolona 18) të shtojcës 1, shuma e kompensimit financiar vihet në dispozicion nga Agjencia e Trajtimit të Pronës, pas zgjidhjes në rrugë gjyqësore të shkakut të kufizimit, sipas pikës 16, të vendimit nr. 465, datë 22.6.2016, të Këshillit të Ministrave.

4. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatësisht, në Tiranë, Vlorë, Elbasan dhe Durrës të kryejë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

5. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtimit të Pronës, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi



AGJENCIA E LEGALIZIMIT DHE INTEGRIMIT TE ZONAVE/NDERTIMEVE INFORMALE
LISTA EMERORE E SUBJEKTEVE QE PREKEN NGA NDERTIMET INFORMALE TE KUALIFIKUARA, MASA DHE VLERA E SHPERBLIMIT

Të dhënat e Pasurisë së Legalizuar					Gjendja juridike (pronesia)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Numri i Pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve								
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit						Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i veçantë
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 1605																	
SOKOL	KAMBER	SKEJA	721589	26.11.2016				1	HANE	KADRI	PALUSHI	1	414/78	899.00	2,560	2,301,440.00	
ELHAMI	AZEM	SHAHU	92455	02.12.2015				2	QEMAL	KADRI	TOTA						
								3	HANISHE	KADRI	BULICA						
								4	BUKURIE	KADRI	SHEHU						
								5	ASLLAN	KADRI	TOTA						
								6	KORAB	KADRI	TOTA						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3321																	
NURI	HYSEN	SALIJA	77348	09.06.2015				7	ABDULLA		XHAMETA	2	425/57	296.10	2,560	758,016.00	
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976																	
FLUTURAK	DYLBER	TARE	91836	13.06.2016				8	SEMIHA	RAMAZAN	XHEMALI	3	42/10	257.60	479	123,390.40	
								9	KUDRETE	RAMAZAN	BRARI						
								10	NAILE	RAMAZAN	BRARI						
								11	ELIMA	SEJKULLA	BRARI						
								12	JOHAN	YLLI	BRARI						
								13	ALBINA	YLLI	BRARI						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976																	
SHEFQET	SHEFQET	SHEHU	72617	01.12.2015				14	MYZEJEN	SEFER	ALLMUÇA	4	258/81	524.00	479	250,996.00	
								15	ENVER	SEFER	ALLMUÇA						
								16	MEHMET	SEFER	ALLMUÇA						
								17	BASHKIM	SEFER	ALLMUÇA						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976																	
BUJAR, SAIMIR	AHMET	XHEPA	76901	28.01.2016				18	PETRIT		LULI	5	224/68	182.60	479	87,465.40	
								19	VJOLLCA		LULI						
								20	FLORA		LULI						
								21	HAXHIRE		LULI						
								22	ARBEN		LULI						
								23	SELIM		LULI						
								24	ELISABETA		LULI						
								25	PETRIT		ÇEÇA						
								26	ENGJELLUSHE		ÇEÇA						
								27	GERSI		ÇEÇA						
BUJAR, SAIMIR	AHMET	XHEPA	76901	28.01.2016				28	PETRIT		LULI	6	224/69	317.40	479	152,034.60	
								29	VJOLLCA		LULI						
								30	FLORA		LULI						
								31	HAXHIRE		LULI						
								32	ARBEN		LULI						
								33	SELIM		LULI						
								34	ELISABETA		LULI						
								35	PETRIT		ÇEÇA						
								36	ENGJELLUSHE		ÇEÇA						
								37	GERSI		ÇEÇA						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 3976																	
RASIM	MEHMET	HIDRI	98344	17.04.2016				38	MYZEJEN	SEFER	ALLMUÇA	7	258/81	852.00	479	408,108.00	
FADIL	XHEMAL	SULA	190074	20.06.2016				39	ENVER	SEFER	ALLMUÇA						
								40	MEHMET	SEFER	ALLMUÇA						
								41	BASHKIM	SEFER	ALLMUÇA						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8120																	



HAVZI	SELIM	DRAZHI	79191	29.02.2016				42	SILVANA		RANKAJ	8	7/915	144.00	29,106	4,191,264.00	
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8120																	
AURORA, TEDI, SINDI	FAHRI, NIKO	VERUSHI	993994	21.08.2016				43	Abdurrahman	.	Harasani	9	10/488	41.60	29,106	1,210,809.60	PASURIA BLLOKOHET NE FAVOR TE ARLIS- NDERTIM SH.P.K. ME K.SIP. 5528/1329, 16.12.2016 RREGJISTROHET KONTRATE POROSIE, K.POROSIE, NR.5499/1326/1 DATE 15.12.2016.
								44	Albana	.	Kamberi						
								45	Besnik	.	Harasani						
								46	Brunilda	.	Mekshi						
								47	Bujar	.	Harasani						
								48	Edmond	.	Harasani						
								49	Enkelelda	.	Çeka						
								50	Gezim	.	Harasani						
								51	Hergi	.	Tabaku						
								52	Fisnik	.	Tabaku						
								53	Hiqmet	.	Kadiu						
								54	Mereme	.	Kasmi						
			55	Paqize	.	Harasani											
			56	Petrit	.	Harasani											
			57	Silvana	.	Kamberi											
			58	Ylli	.	Harasani											
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8150																	
GENC	SEFER	ZELA	91671	26.05.2016				59	ODHISEA	KRISTO	ANAGNOSTI	10	6/305	5.80	66,969	388,420.20	
								60	AGRON	ADIL	MAHMUTI						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170																	
LUTFI	VATH	BOJA	91511	12.05.2016				61	SHEFQET		KOKONOZLM	11	3/846	279.70	32,878	9,195,976.60	Kjo pasuri krijon mbivendosje sipas dok.ligjor me nje sip prej 35,2 m2 me pasurine 3/828, vol 22 fq.92, ZK.8170
								62	MARJETA	ESAT	MEÇE	12	3/845	97.10	32,878	3,192,453.80	
								63	FOTI	ENVER	MEÇE						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170																	
NEXHMI	HEKURAN	SHKEMBI						64	BANKA	KOMBETAR E	TREGETARE	13	1/355	305.10	32,878	10,031,077.80	
								65	ERGYS	SHYQYRI	KADIU	14	1/650	3.90	32,878	128,224.20	
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170																	
FATOS	ENVER	AGA	88355	09.09.2014				66	GENCI	BEQIR	LULI	15	11/195	12.50	32,878	410,975.00	
								67	YLLI	ISUF	LULI	16	11/178	3.00	32,878	98,634.00	
								68	BUKURIJE	MYSLIM	LULI (DEDE)	17	11/193	26.20	32,878	861,403.60	
								69	ENEA	SHKELQIM	LULI						
								70	FLUTURA	MYSLIM	LULI (SHAKAJ)						
								71	ILIRJAN	MYSLIM	LULI						
								72	LINDITA	DANI	LULI						
								73	XHENI	SHKELQIM	LULI						
QARKU TIRANE ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8170																	
RESHAT, BESNIK	HAZIS	KODRA	97225	31.03.2015				74	BASHKIM		TABAKU	18	7/255	8.70	32,878	286,038.60	
								75	BESIM		TABAKU						
								76	BURHAN		TABAKU						
								77	DHURATA		KUSHI						
								78	MIMOZA		TABAKU						
								79	ALTIN		GJOLIGAJ	19	7/256	10.10	32,878	332,067.80	
								80	ARJAN	REXHEP	TABAKU						
								81	KRESHNIK		GJOLIGAJ						
								82	RIDVAN	REXHEP	TABAKU						
								83	SUZANA	REXHEP	TABAKU						
RESHAT, BESNIK	HAZIS	KODRA	97225	31.03.2015				84	Bashkim		Tabaku	20	7/257	179.40	32,878	5,898,313.20	Prona eshte e bllokuar me kontrat sipermarje 688/2174, dt.20.03.2009
ABDYL	SELIM	FUSHA	77102	27.05.2015				85	Besim		Tabaku						
								86	Dhurata		Tabaku (Kushi)						
								87	Mimoza		Tabaku						



RESHAT, BESNIK	HAZIS	KODRA	97225	31.03.2015				88	Burhan		Tabaku						
ABDYL	SELIM	FUSHA	77102	27.05.2015				89	ARJANA		CANAJ,(TABAKU)	21	7/258	213.20	32,878	7,009,590	Prona eshte e bllokuar me kontrat sipermarje 688/2174, dt.20.03.2009
								90	KRESHNIK		GJOLIGAJ						
ABDYL	SELIM	FUSHA	77102	27.05.2015				91	SUZANA		ÇUÇI(TABAKU)						
SHAQIR	GANI	GJINI	97237	01.04.2015				92	Bashkim		Tabaku						
								93	Besim		Tabaku	22	7/259	314.70	32,878	10,346,706.60	Prona eshte e bllokuar me kontrat sipermarje 207/2009
								94	Dhurata		Tabaku (Kushi)						
								95	Mimoza		Tabaku						
								96	Burhan		Tabaku						
Figura 5 paraqet LCOE për PV. Shumica e vlerave të LCOE për 1 MW impiant referent Fotovoltaik diellor qëndrojnë në rangun prej 185 €/MWh në 195€/MWh, ndërsa me Greqinë (120 €/MWh) dhe Hungarinë (155 €/MWh), si të veçuara më të ulëta. Për Greqinë, ky është një kombinim i rrezatimit të lartë diellor (me mbi 1500 orë me ngarkesë të plotë të supozuara në këtë model) dhe mbështetjes afatgjatë. Për Hungarinë (1.050 orë me ngarkesë të plotë) dhe kostoja e ulët e kapitalit e rëndësishme.

Konkluzione

- Në këtë analizë janë vlerësuar propozime të kostove me qëllim të vendosjes së një çmimi tavan (fillestar) për energjinë elektrike të prodhuar me impiante Eolike dhe PV. Qëllimi është vendosja e çmimit fillestar për impiantet e vogla bazuar në këtë metodologji të llogaritjes së LCOE dhe

WACC, në kushtet kur Shqipëria nuk ka eksperiencën të deritanishme për investime në këto teknologji. Çmimi fillestar i llogaritur gjithashtu shërben si nivel maksimal dhe vendoset si një nga elementët me qëllim organizimin e ankandeve.

- Teorikisht dhe praktikisht, WACC - **Kostoja Mesatare e Ponderuar e Kapitalit** duhet të jetë e barabartë me normën mesatare të kthimit që një kompani pret për të kompensuar të gjithë investitorët e saj të ndryshëm, të cilët janë pjesë e çdo burimi të financimit në strukturën e kapitalit të synuar të kompanisë. Kjo vlen edhe për kompanitë që dëshirojnë të investohen në teknologjitë Eolike dhe PV.

- Duke qenë se krahasimi është bërë me Vendet e Evropës Juglindore (WB6), ku përfshihet edhe Shqipëria, që përgjithësisht kanë çmime të ulëta të energjisë elektrike, kostot e konkurrencës për gjenerimin e impianteve PV dhe Eolike, ndikojnë ndjeshëm në çmime të ulëta. Në të kundërt, vendet e BE në këtë rajon, të cilat kanë çmime më të larta të tregut, reflektohet gjithashtu në kostot e gjenerimit të këtyre impianteve duke ofruar çmime të larta të konkurrencës. *Analiza jonë është bërë duke marrë në konsideratë të dy tendencat.* Siç duket nga shembujt e mësipërm, p.sh. PV-të në Greqi është 120 Euro/MWh (vend i BE me kushtet natyrore të ngjashme me Shqipërinë), ndërsa për impiantet Eolike 96 Euro/MWh.

**Në përfundim:**

1. Duke marrë në konsideratë llogaritjet e kryera nga studimet e IRENA dhe ECOFYS për LCOE dhe WACC në kushtet e vendit tonë, në mungesë të eksperiencës të aplikimit dhe operimit të këtyre impjanteve, çmimi i mesatarizuar për secilën teknologji për vitin 2017 rezulton sipas tabelës së mëposhtme:

Teknologjia		PV	Eolike
LCOE	2017 (€/MW)	1,400	1,450
	2018 (€/MW)	1,300	1,400
	2019 (€/MW)	1,000	1,350
WACC	2017 (%)	8.8	8.8
	2018 (%)	8.0	8.0
	2019 (%)	7.5	7.5
Çmimi i mesatarizuar për vitin 2017	(€/MWh)	100	76

2. Mbështetur në ligjin 7/2017, nen 10, pika 3, Enti Rregullator i Energjisë do të miratojë çmimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017 sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së mësipërme përsa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

3. Ky çmim do të shërbejë si nivel i çmimit mbi bazën e të cilit do të përzgjidhen përfituesit e skemës së mbështetjes, sipas kontratës për diferencë, si një prej elementëve të procedurës konkurruese, në përputhje me parashikimet e nenit 9, pikat 2, 3 dhe 4, të ligjit 7/2017.

VENDIM**Nr. 370, datë 26.4.2017**

**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E KOLEGJIT
PROFESIONAL TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kolegji profesional i lartë organizohet si institucion i arsimit të lartë ose si njësi kryesore e universiteteve apo kolegjeve universitare dhe

përfaqëson një strukturë të përbërë nga, së paku, dy departamente.

2. Kolegji profesional i lartë vepron në fushën e arsimit të orientuar profesional dhe përgatit profesionistë me aftësi praktike.

3. Departamenti i kolegjit është njësi e zhvillimit të mësimdhënies dhe trajnimit, i cili përfshin fusha të përafërta dhe grupon disiplinat mësimore trajnuese të përafërta. Ai është përgjegjës për programet e studimit që ofron.

4. Departamenti i kolegjit nxit, programon, bashkërendon, zhvillon, organizon dhe administron veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë të trajnimit.

5. Departamenti i kolegjit ka në përbërje të tij, të paktën, pesë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë si personel mësimdhënës, nga të cilët, të paktën, një me gradë shkencore ose titull akademik. Kolegjet profesionale të larta, departamentet e të cilave kanë programe studimi që zgjasin dy vite akademike, me 120 kredite (ECTS), kanë, të paktën, dy pedagogë me gradë shkencore ose titull akademik për çdo departament. Departamenti mund të ketë në përbërje edhe personel ndihmës mësimdhënës.

6. Kolegji profesional i lartë ofron programe të akredituara që zgjasin një ose dy vite akademike, me 60 ose 120 kredite (ECTS) dhe për të cilat lëshohet certifikatë ose diplomë profesionale.

7. Kolegji profesional i lartë, kur organizohet si institucion i arsimit të lartë, ka organe dhe autoritete drejtuese. Organet drejtuese janë Senati Akademik, Asambleja e Personelit Mësimdhënës dhe Bordi i Administrimit, ndërsa autoritetet drejtuese janë rektori, drejtuesi i departamentit dhe administratori i kolegjit.

8. Kolegji profesional i lartë, kur organizohet si njësi kryesore e universiteteve ose kolegjeve universitare, ka vetëm autoritete drejtuese. Autoritetet drejtuese janë drejtori, drejtuesi i departamentit dhe administratori i kolegjit.

9. Në kolegjet profesionale të larta, publike, organet dhe autoritetet drejtuese zgjidhen sipas përcaktimeve të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

10. Në kolegjet profesionale të larta, jopublike, organet dhe autoritetet drejtuese përzgjidhen/emërohen dhe shkarkohen sipas përcaktimeve në statutin e institucionit, të miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin.



11. Në kolegjet profesionale të larta, Senati Akademik përbëhet nga jo më pak se pesë anëtarë dhe rektori është kryetari i Senatit Akademik.

12. Në kolegjet profesionale të larta, rektori ose drejtori mban titullin “Profesor” ose “Profesor i asociuar”.

13. Anëtarët e Senatit Akademik të kolegjit i përkasin kategorisë “Profesor” ose kanë gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull/gradë shkencore dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.

14. Në kolegjet profesionale të larta, drejtuesi i departamentit i përket kategorisë “Profesor” ose ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”), të fituar pranë universiteteve të vendeve anëtare të OECD-së ose BE-së. Në mungesë të autoriteteve drejtuese me këtë titull/gradë shkencore dhe për efekt të përfaqësimit, kategoria e tyre mund të zbresë, sipas përcaktimeve të bëra në statutin e institucionit.

15. Bordi i Administrimit të kolegjit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Në institucionet publike të arsimit të lartë një nga anëtarët zgjidhet nga Senati Akademik, ndërsa dy anëtarët e tjerë përzgjidhen/emërohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në institucionet jopublike të arsimit të lartë, anëtarët e Bordit të Administrimit zgjidhen sipas përcaktimeve në statutin e institucionit të arsimit të lartë.

16. Administratori i Kolegjit emërohet nga Bordi i Administrimit ose nga administratori i universitetit/kolegjit universitar. Administratori duhet të ketë arsim të lartë, së paku në nivelin “Master i Shkencave” në fushën e drejtësisë ose të ekonomisë dhe përvojë pune, së paku pesë vjet, në këto fusha.

17. Për veprimtarinë e kolegjeve profesionale të larta dhe të studentëve në këto kolegje respektohen dispozitat e ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

18. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 371, datë 26.4.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1013, DATË 10.12.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË PROVIMEVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1013, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në titull dhe kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimi “Agjencia Kombëtare e Provimeve” zëvendësohet me “Qendra e Shërbimeve Arsimore”.

b) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. QSHA-ja është institucion i posaçëm për organizimin, monitorimin, mbikëqyrjen e problemeve të reformës arsimore për sigurimin e cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve dhe të provimeve. Ajo ushtron funksion teknik, profesional, mbështetës dhe rekomandues të politikave të vlerësimit dhe të organizimit të provimeve të maturës e të shtetit.”.

c) Pikat 4, 5, 6 dhe 7 shfuqizohen.

ç) Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. QSHA-ja kryen këto funksione:

a) Zhvillon provimet kombëtare, kryen procesin e vlerësimit të arritjes së nxënësve dhe administron bazën e të dhënave të këtyre rezultateve.

b) Kryen dhe administron vlerësime të jashtme kombëtare dhe ndërkombëtare dhe/ose me kampionim për arritjet e nxënësve të sistemit arsimor parauniversitar.



c) Ofron kontribut në hartimin e politikave arsimore e të strategjive dhe në zbatimin e tyre.

ç) Përpunon dhe analizon rezultatet e provimeve kombëtare, të vlerësimeve, të provimeve të shtetit, sipas standardeve bashkëkohore, dhe raportet vjetore të cilat i publikon.

d) Organizon dhe administron Provimin e Shtetit, që zhvillohet përmes teknologjisë digjitale, duke bashkëpunuar me autoritetet kompetente përkatëse, sipas ligjit për profesionet e rregulluara.

dh) Krijon bazën shtetërore të të dhënave për kandidatët e regjistruar në Provimin e Shtetit.

e) Digitalizon fondet e pyetjeve të miratuara nga komisionet e Provimit të Shtetit dhe e zhvillon këtë provim, përmes teknologjisë digjitale.

ë) Trajnon periodikisht personelin organizues dhe mbikëqyrës të Provimit të Shtetit dhe të provimeve kombëtare.

f) Publikon *on-line* programin orientues të këtij provimi dhe fondet e pyetjeve për çdo profesion të rregulluar.

g) Administron bazën e të dhënave për arsimin parauniversitar.

gj) Krijon, arkivon, përditëson dhe administron bazën elektronike të të dhënave për arrijtjet e nxënësve në provimet kombëtare.

h) Kontribuon në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë pjesë e objektit të veprimtarisë së saj.”.

d) Pikat 9, 10 dhe 11 shfuqizohen.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 372, datë 26.4.2017

**PËR MIRATIMIN E AGJENDËS
KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E
FËMIJËVE, 2017-2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjave "a", "b", dhe "c", të pikës 1, të nenit 35, të ligjit nr. 10 347, datë 4.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës", me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

Faqe | 5598

VENDOSI:

1. Miratimin e Agjencës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2017-2020.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 373, datë 26.4.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 308, DATË 21.5.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E
PAKETAVE TË SHËRBIMEVE
SHËNDETËSORE QË DO TË
FINANCOHEN NGA FONDI I
SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
KUJDESIT SHËNDETËSOR NË
SHËRBIMIN SPITALOR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 308, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Shtojcat e përmendura në pikën 1, që i bashkëlidhen vendimit, ndryshohen, përkatësisht:

a) Shtojca nr. 1, "Paketa e shërbimit të dializës", zëvendësohet me shtojcën nr. 1, "Paketa e shërbimit të dializës, të vendosjes së fistulës së thjeshtë, vendosjes së grafitit të thjeshtë", që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) Shtojca nr. 2, "Paketa e shërbimeve të kardiologjisë", zëvendësohet me shtojcën nr. 2, "Paketa e shërbimeve të kardiologjisë", që i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) Shtojca nr. 3, "Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë", zëvendësohet me shtojcën nr. 3, "Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë", që i bashkëlidhet këtij vendimi;



c) Shtojca nr. 4, “Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës”, zëvendësohet me shtojcën nr. 4, “Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës dhe flakjes akute”, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

d) Shtojca nr. 5, “Paketa e shërbimit të implantit koklear”, zëvendësohet me shtojcën nr. 5. “Paketa e shërbimit të implantit koklear”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pikat 5 dhe 6 ndryshohen, me këtë përmbajtje:

“5. Paketat e shërbimeve zbatohen në bazë të protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

6. Fondi administron Regjistrin Kombëtar të Paketave të shërbimeve shëndetësore. Rregullat, kriteret dhe mënyra e organizimit të Regjistrit

Kombëtar të Paketave, të financuara nga Fondi, hartohen nga ky i fundit dhe miratohen nga Këshilli Administrativ i tij.”.

3. Në pikën 8, fjalët “...nga shërbimet shëndetësore publike dhe private...” zëvendësohen me “...nga shërbimet shëndetësore publike...”.

4. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Për të gjitha institucionet shëndetësore publike, përdorimi i marzhit të fitimit, i përcaktuar sipas shtojcave përkatëse, do të bëhet me vendim të posaçëm të Këshillit Administrativ të Fondit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Shtojca nr. 1

Paketa e shërbimit të dializës		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	Seanca e dializës Në këtë paketë përfshihen: - Ekzaminimet e nevojshme biokimike klinike dhe mikrobiologjike. - Kryerja e procedurës.	11,530.00	5%	12,106.00
2.	Kryerja e interventin për vendosjen e fistulës	10,127.00	8%	10,937.00
3.	Kryerja e interventin për vendosjen e grafitit - Në këtë paketë përfshihen interventi dhe grafti me përbërje të thjeshtë.	62,187.00	8%	67,162.00

Shtojca nr. 2

Paketa e shërbimeve të kardiologjisë		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	Angiografi koronare Në këtë paketë përfshihen: procedura dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	58,067.83	8%	62,713.26
2.	Angioplastikë koronare (PTCA + stent) Në këtë paketë përfshihen: procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	137,415.00	8%	148,408.01
3.	Angiografi koronare + Angioplastikë koronare (PTCA + stent) Në këtë paketë përfshihen procedura: një ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	147,346.00	8%	159,133.68
4.	Pacemaker definitiv Në këtë paketë përfshihen procedura, një ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe një ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).	138,404.53	8%	149,476.89
4/1	Procedura e vendosjes së aparatit	61,229.53	8%	66,127.89
4/2	Vlera e pacemakerit 73.500 lekë.			73,500.00

Shtojca 3

Paketa e shërbimeve të kardiokirurgjisë:		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	By-Pass aorto koronar	521,735.74	8%	563,474.60
1/1	By-Pass+plastike e valvules	603,362.74	8%	651,631.76
1/2	By-Pass+zevendësim me valvul mekanike	595,392.24	8%	643,023.62
1/3	By-Pass+zevendësim me valvul biologjike	614,445.26	8%	663,600.88
1/4	By-Pass+zevendësim me valvul mekanike: 1 valvul aortale+1 valvul mitrale	712,530.24	8%	769,532.66
-	Në këto paketa përfshihen një ditë qëndrimi pre operator, ndërhyrja, dy			



	ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe pesë ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).			
2.	Valvolar			
2/1	Mono valvular me proteze mekanike	593,845.99	8%	641,353.67
2/2	Mono valvular me proteze biologjike	619,638.19	8%	669,209.25
2/3	BI valvular me proteze mekanike	697,771.95	8%	753,593.71
2/4	BI valvular me proteze biologjike	735,231.93	8%	794,050.48
-	Në këto paketa përfshihen një ditë qëndrimi pre operator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive si dhe pesë ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).			
3.	Congenital	397,002.75	8%	428,762.97
	Në këtë paketë përfshihen një ditë qëndrimi pre operator, ndërhyrja, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive në shërbimin e Kardiokirurgjisë, dy ditë qëndrimi në terapinë intensive në shërbimin e Pediatrisë si dhe pesë ditë qëndrimi në pavion (duke përfshirë edhe ekzaminimet).			

Shtojca nr. 4				
Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës (me dhurues të gjallë)		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
1.	Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës është 1,109,719 lekë me marzh fitimi 8 % 1,198,496 lekë.	1,109,719.00	8%	1,198,496.00
-	Në këtë paketë përfshihen:			
-	Ekzaminimet para transplantit për marrësin e dhuruesin:			
-	- klinikë biokimike;			
-	- imunologjike;			
-	- markuesit tumoralë;			
-	- imazheri virologjike;			
-	Konsultat;			
-	operacioni dhe ndjekja;			
-	ekzaminimet pas transplantit për marrësin e dhuruesin;			
-	terapia e induksionit;			
-	imunopresoret (dozimi në gjak).			
1/1	Terapia e flakjes akute	459,553.00	8%	496,317.00

Shtojca nr.5				
Paketa e shërbimit të implantit koklear:		kosto në lekë	marzhi i fitimit në përqindje	çmimi në lekë
-	interventi kirurgjikal	192,425.00	8%	207,819.00
-	aparati			2,704,600.00
	-totali			2,912,419.00
	Në këtë paketë përfshihen: ndërhyrja dhe aparatura e implantit koklear sipas standardeve të BE-së			

Fondi të bëjë rakordimet me spitalet publike për zbritjen e pjesës së kostove që paguhen në kontratat koncensionare

VENDIM

Nr. 374, datë 26.4.2017

PËR MBULIMIN E PLOTË TË SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. ARBEN HYSKO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e plotë të shpenzimeve të mjekimit të z.Arben Hysko, në masën 2 300 000 (dy milionë e treqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Paga të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 375, datë 26.4.2017****PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ.
ENKELEJDA MAMAJ (BABA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Enkelejda Mamaj (Baba), në masën 3 000 000 (tre milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 376, datë 26.4.2017****PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË
SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ.
ANXHELA NOÇKA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, dhe në vijim të shkronjës “c”, të pikës 9, të vendimit nr. 18, datë 11.1.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2017”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit të znj. Anxhela Noçka, në masën

3 000 000 (tre milionë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****VENDIM****Nr. 377, datë 26.4.2017****PËR DHËNIE PENSIONI TË POSAÇËM
FAMILJARËVE NË NGARKIM TË TË
NDJERIT ANDREA STEFANI**

Në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie, përjashtimisht nga kriteret e vendimit nr.429, datë 12.2.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të një pensioni të posaçëm familjar për personat në ngarkim të të ndjerit Andrea Stefani.

2. Pensioni i posaçëm familjar ose shtesa e pensionit familjar të jetë deri në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj. Përfitues të pensionit ose shtesës së pensionit janë personat e përcaktuar sipas kushteve që parashikon neni 40, i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Shuma, kur kërkohet nga familjarët, jepet e ndarë në mënyrë të barabartë për çdo përfitues.

3. Efekti financiar, prej 400 000 (katërqind mijë) lekësh, për vitin 2017 dhe për vitet në vazhdim, të përballohet nga buxheti i sigurimeve shoqërore.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2017.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**

**VENDIM****Nr. 378, datë 26.4.2017**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “RIKUALIFIKIMI URBAN I
BLOKUT TË KUFIZUAR NGA RRUGËT
‘SULEJMAN DELVINA’, ‘MEDAR
SHTYLLA’, ‘SKËNDER LUARASI’,
‘GRIGOR HEBA’ DHE ‘GJIK KUQALI’,
TIRANË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi urban i bllokut të kufizuar nga rrugët ‘Sulejman Delvina’, ‘Medar Shtylla’, ‘Skënder Luarasi’, ‘Grigor Heba’ dhe ‘Gjik Kuqali’, Tiranë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “tokë truall” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 115 185 048 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyzet e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 115 185 048 (njëqind e pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e dyzet e tetë) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Tiranë.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në “Fletoren zyrtare” dhe të përfundojë me mbylljen e punimeve.

7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Tiranë.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**



Pasuritë që preken nga projekti për "Rikualifikim Urban i Bllokut të kufizuar nga rr. "Sulejman Delvina", "Medar Shtylla", "Skënder Luarasi", "Grigor Heba", "Gjik Kuqali" (Faza e Parë)

Nr	Emër Atësia Mbiemër	Z. K.	Nr. pas.	Sip. përgj. truall m ²	Sip. prekur truall m ²	Çmimi për truall lekë/m ² .	Objekti sip. Përgj. m ²	Objekti sipërfaqja preket m ²	Çmimi për objekt lekë/m ²	Vlera (truall i prekur) lekë	Vlera (objekt i prekur) lekë	Vlera (truall + objekt) lekë	KONFIRMIM ZVRPP, TIRANË
1	Bashkëpronarët Kika, Pleshti, Verzivoll	8260	6/340	1045	403	30783				12405549	0	12405549	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
2	Shtet	8260	6/67	50.35	29	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
3	Shtet	8260	6/537	284.3	134	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
4	Bashkëpronarët , Papa, Buda, Xheka, Stasoli, Kostandini, Kumani, Kisi, Tona, Panajoti, Kasimati, Gero, Basko, Leka, Kristuli, Bele, Jançe, Tiço, Poda, Prifti, Tasi	8260	4/430	737	90	30783				2770470	0	2770470	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
5	Shtet	8260	6/517	2618.18	990	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
6	Bashkëpronarët Gama, Pinari, Kalemi, Kukaleshi, Kusi, Kristani	8260	6/282	416	416	30783				12805728	0	12805728	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
7	Shtet	8260	6/641	1171.09	3.6	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
8	Shtet	8260	6/68	127.47	127.47	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
9	Fatmira Sinani	8260	6/68/ND	0	0	0	127	127	103254	0	13113258	13113258	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/3 datë 30.06.2016
10	Erion Stilian Thomai	8260	6/283	600	91	30783				2801253	0	2801253	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
11	"Haxhiu" shpk	8260	6/675	3114	0	0				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
12	"Haxhiu" shpk	8260	6/676	1872	0	0				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
13	Bashkëpronarët Kika, Vorpsi, Pleshti, Verzivoll	8260	6/344	420	353	30783				10854086	0	10854086	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
14	Flutura Qazim Verzivoll	8260	6/354	662	129	30783				3971007	0	3971007	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
15	Shtet	8270	6/458	60	40	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
16	Mynyvere Neim Spaho	8270	6/102	640	61	66969				4085109	0	4085109	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
17	Shtet	8270	6/2	503	281	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
18	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/356	380	127	66969				8511760	0	8511760	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
19	Bashkëpronarët Kasmi	8270	6/233	69	0	0				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
20	Shtet	8270	6/443	141	52.5	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
21	Shtet	8260	4/118	1421	1376	30783				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
22	Shtet	8270	6/116	87	31.5	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
23	Shtet	8270	8/648	384	12.5	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
24	Bahri Osman Pinari	8270	6/318	140	3.5	66969				234392	0	234392	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
25	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8260	4/437	107.2	7	30783				215481	0	215481	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
26	Mynevere Neim Spaho	8260	4/113	390	162	30783				4986846	0	4986846	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
27	Bashkëpronarët Dimitresku e Santo	8260	4/111	124	18	30783				554094	0	554094	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
28	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero,	8260	4/435	379.5	92	30783				2832036	0	2832036	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016



	Kasimati											
29	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8260	4/436	317.8	148	30783			4555884	0	4555884	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
30	Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Tase, Pambuku, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Spaho, Kristuli, Bele	8260	4/384	90	47	30783			1446801	0	1446801	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
31	Shtet	8260	4/610	232.86	212	30783			0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
32	Shtet	8260	4/253	568.65	564	30783			0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
33	Nezir Alla	8260	4/253/ND		0	0	167.7	167.7	67749.74	0	11361631	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/3 datë 30.06.2016
34	Ardian Dashi	8260	4/251/ND		0	0	94.4	94.4	103254	0	9747178	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/3 datë 30.06.2016
35	Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Prifti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Dervishi, Tiço, Xheka, Stastoli	8260	4/387	175	34	30783			1046622	0	1046622	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
36	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8260	4/444	149	29	30783			892707	0	892707	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
37	Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Prifti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Dervishi, Tiço, Xheka, Stastoli	8260	4/386	140	10	30783			307830	0	307830	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
38	Bashkëpronarët Kisi, Guga, Kumani, Jançe, Tona, Prifti, Tase, Vodo, Sapiqoti, Panajoti, Kasimati, Gero, Leka, Basko, Kristuli, Bele, Papa, Buda, Dervishi, Tiço, Xheka, Stastoli	8260	4/388	130	10	30783			307830	0	307830	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
39	Frensis Shkëlqim Spaho, Elvana Stefan Spaho	8260	4/540	598.02	5	30783			153915	0	153915	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
40	Shtet	8260	4/254	109.4	105	30783			0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
41	Pasuria e pozicionuar në hartë ndërmjet pas. nr. 6/233 zk. 8270 dhe pas.nr.6/469 zk.8270	8270			20	66969			1339380	0	1339380	në shkresën e ZVRPP - është shënimi pa informacion
42	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/360	599	33	66969			2209977	0	2209977	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
43	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini, Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati	8270	6/358	83.4	17	66969			1138473	0	1138473	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
44	Bashkëpronarët Spaho, Tasi, Tona, Papa, Stasoli, Xheka, Kisi, Panajoti, Buda, Leka, Basko, Poda, Kumani, Kostandini,	8270	6/357	33.6	8	66969			535752	0	535752	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016



	Kristuli, Jançe, Bele, Tiço, Gero, Kasimati												
45	Shtet	8270	6/441	216	187	66969				0	0	0	Konfirm. ZVRPP me shkresën nr. prot. 5034/1 datë 11.03.2016
	SHUMA				6458,77			389.1		80962981.2	34222067	115185048	

SHËNIM:

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja 89, dt.03.02.2016.
2. Për objektet çmimi për llogaritje është marrë nga Udhëzimi Nr.4 datë 30.09.2015 "për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2015" dhe shkresës së ZVRPP Tiranë nr. prot. 30329/3, datë 12.01.2017
3. Pasuritë e prekura nga projekti, Konfirmohen nga ZVRPP, Tiranë, me shkresat nr.prot. 5034/1, datë 11.03.2016 dhe nr. prot. 5034/3, datë 30.06.2016
- 4.Pasuria e pozicionuar në hartë ndërmjet pas. nr. 6/233 zk. 8270 dhe pas.nr.6/469 zk.8270 në fragmentin e hartës që shoqëron shkresën nr.prot. 5034/1, datë 11.03.2016 të ZVRPP Tiranë ka shënimin pa informacion.
5. Pasuritë me nr 6/233 zk. 8260, nr. 6.675 zk. 8260, nr. 6/676 zk 8260 janë menaxhuar me leje ndërtimi

**VENDIM****Nr. 379, datë 26.4.2017**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË
SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKET NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “NDËRTIMI I KOLEKTORIT
KRYESOR TË UJËRAVE TË ZEZA DHE
I.T.U.P NË ZONËN TURISTIKE GJIRI I
LALËZIT, DURRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Ndërtimi i kolektorit kryesor të ujërave të zeza dhe I.T.U.P në zonën turistike gjiri i Lalëzit, Durrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë “arë” me sipërfaqe të përgjithshme 10 475 (dhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) m², me vlerë të përgjithshme të shpronësimit prej 4 158 575 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasurinë “arë”, prej 4 158 575 (katër milionë e njëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekësh, do të përballohet nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri shpronësime për objektet buxhetore, për programin furnizimi me ujë dhe kanalizime, me kodin M063141.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurisë, për të cilën është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësjetllës-Kanalizimeve të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve si dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasurinë e shpronësuar, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasurinë e shpronësuar.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizimeve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA "NDËRTIMI I KOLEKTORIT KRYESOR TË UJËRAVE TË ZEZA
DHE I.T.U.P. NË ZONËN TURISTIKE GJIRI I LALËZIT, DËRRËS"

Nr.	Pronari		Z.K.	Nr.pas	Lloji i pas.	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Mbiemri								
1	Zihni Besnike Devis Rexhep Klodjan	Dana	2332	527/10	Arë	10475	10475	397	4158575	Konfirmuar nga ZVRPP
SHUMA TOTALE							10475		4158575	

VENDIM

Nr. 380, datë 26.4.2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 274, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN,
PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
NDËRTIMI I RRUGËS QË LIDH
NDËRTESËN E RE TË QENDRËS
DISPEÇER DHE ZYRAT E "OST", SH.A.-
SË, ME NËNSTACIONIN 400 KV
KASHAR"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 274, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Tabela e përmendur në pikën 1 zëvendësohet me tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Pikat 3 dhe 4 ndryshohen, si më poshtë vijon:

"3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen prej 6 330 (gjashtë mijë e treqind e tridhjetë) m², "tokë bujqësore arë", vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 2 702 225 (dy milionë e shtatëqind e dy mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 2 702 225 (dy milionë e shtatëqind e dy mijë e dyqind e njëzet e pesë) lekësh, të përballohet nga fondet e "OST", sh.a.-së."

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, "OST", sh.a.-ja, dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



OPERATORI SISTEMIT TE TRANSMETIMIT

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGES QË LIDH QENDRËN DISPECER ME NËN/STACIONIN 400 kV TIRANA 2

Nr.	Lista e pronarëve për shpronësim definitiv (sip. tokë bujqësore)															
	Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. Kadastral	Nr. Pasurisë	Prona në m ² (totale)	Gjendja juridike nga ZVRPP	Sip. rrugë m ²	Cmimi i tokës lek/m ²	Vlera në lek për tokën	Lloji i kulturës	Cmimi i kulturës në lek/ha	Vlera në lek për kulturën	Vlera totale në lek	Shënime
Qarku Tiranë																
Njesia Administrative Kashar																
1	Ali	Shaban	Sula	arë	2105	1/19	1565	pronar	180	415	74700	asëll	73000	1332	76032	çertifikatë 23.11.2007
2	Ali	Shaban	Sula	arë	2105	9/1/	2650	pronar	130	415	53950	asëll	73000	962	54912	pa çertifikatë
3	kanal							shtet	20							
4	Xhemal	Ymer	Sula	arë	2105	976/6/	1343	pretendues	220	415	91300	rruge			91300	pa çertifikatë
5	Shkelqim	Osman	Sula	arë	2105	976/10/	1440	pretendues	90	415	37350	rruge			37350	pa çertifikatë
6	Hajdar	Ymer	Sula	arë	2105	976/11/	2900	pronar	140	415	58100	rruge			58100	çertifikatë 21.01.2007
7	Ramazan	Hamza	Sula	arë	2105	976/13/	4240	pretendues	185	415	76775	rruge			76775	pa çertifikatë
8	Bashkim	Hamza	Sula	arë	2105	976/14/1	16000	pronar (b.p)	800	415	332000	rruge			332000	çertifikatë 20.07.2007
9	Jakup	Ramazan	Murataj	arë	2105	976//18/1	4650	pretendues	270	415	112050	rruge			112050	pa çertifikatë
10	Mustafa	Ramazan	Murataj	arë	2105	976//18/2	3675	pronar	200	415	83000	jonxhe	74000	1480	84480	çertifikatë 09.01.2008
11	Musa	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/5	4200	pronar	180	415	74700	jonxhe	73500	1332	76032	çertifikatë 09.01.2008
12	Muhamet	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/6	3910	pronar	160	415	66400	miser	73500	1184	67584	çertifikatë 12.12.2008
13	Musa	Ramazan	Murataj	arë	2105	976/18/7	3911	pronar	240	415	99600	miser	73500	1776	101376	çertifikatë 12.12.2008
14	Lulzim	Pellumb	Beqiri	arë	2105	115/12/	2650	pronar	800	415	332000	miser	74000	5920	337920	çertifikatë 08.12.2003
15	kanal				2105	440		shtet	50							
16	Rustem	Qerim	Sula	arë	2105	116/2/	8800	pretendues	560	415	232400	25 rrënjë, ftonj, shegë, kumbulla			232400	pa çertifikatë
17	Rustem	Qerim	Sula	arë	2105	117a		pretendues	260	415	107900	jonxhe	73500	1924	109824	pa çertifikatë
18	kanal				2105	427		shtet	45							
19	Rustem	Qerim	Sula	arë	2105	1118/1/		pretendues	1800	415	747000	ulli 1 rr, shegë 2 rr, mollë 3 rr, kumbu 6 rr, ftua 5 rr, total 21-24		107090	854090	pa çertifikatë
								SHUMA	6330		2579225			123000	2702225	

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 364 lekë